

# RAPORT

## Dëgjese publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë

### “Analiza dhe Vlerësimi i Gjendjes Ekzistuese”

Sot, më datë 29.02.2016, u organizua dëgjesa publike në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, me temë “Analiza dhe Vlerësimi i Gjendjes Ekzistuese”. Pjesëmarrës ishin profesionistë të fushës së planifikimit dhe të ndërtimit, grupe të ndryshme interesi, qytetarë dhe përfaqësues të AKPT-së.

Takimi u hap me fjalën e kryetarit të Bashkisë Korçë, e cila u pasua nga prezantimi i analizës dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese nga ekspertët e studios konsulente. Prezantimi në përmbajtje të tij kishte:

Platformën e Planit të Përgjithshëm Vendor

Skemën e projektit për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor

Profilin e Bashkisë së re

Parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar për rajonin e Korçës

Parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të qytetit të Korçës

Analizën e zhvillimit social, ekonomik dhe të dhënat mbi arsimin

Analizën mbi mobilitetin dhe transportin



Pas prezantimit, u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilave iu përgjigjën ekspertët e studios konsulente, specialistët e D.P.K.Zh.T dhe të AKPT.

- Një nga pyetjet e para ishte nëse Plani i Përgjithshëm Vendor do të jetë në të njëjtën linjë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar, më konkretisht nëse do të parashikojë ndërtimin e aeroportit apo kalimin e linjës hekurudhore në qytetin e Korçës. Eksperti i transportit i studios konsulente sqaroi se edhe nëse këto parashikime konkrete nuk janë pjesë e PPK, gjithsesi ato parashikohen nga programe të tjera, si SEETO për vitin 2015 – 2016, në të cilin përcaktohet lidhja me rrjet hekurudhor e Shqipërisë me Greqinë nëpërmjet Kapshticës.
- Pyetjes nëse Plani i Përgjithshëm Vendor do të marrë në konsideratë Planin ekzistues të miratuar në vitin 2014 dhe Rregulloren e Qendrës Historike, iu përgjigj specialistja e AKPT, e cila sqaroi se Plani i Përgjithshëm Vendor, i miratuar në vitin 2014 është në fuqi, sikurse dhe Rregullorja e Qendrës, kurse Planet Rregulluese të ish komunave janë shfuqizuar.
- Nga pjesëmarrësit u bë një sugjerim për studion konsulente, në lidhje me kryerjen e analizave SWOT gjatë kronologjisë së punës. Ekspertët e studios siguruan se analizat SWOT do të jenë patjetër pjesë e punës në vazhdim
- Një problematikë e ngritur nga specialist i bujqësisë ishte sfida për urbanizimin e zonave rurale dhe fakti se prodhimi bujqësor është nën juridiksionin e Ministrisë përkatëse. Ky konstatim u shoqërua dhe me një sugjerim nga ana e tij për planifikimin e nj sinergjie të mirë midis zonës rurale dhe atë urbane brenda Bashkisë së re dhe industrializimin e zonës rurale. Ekspertët e studios konsulente janë përgjigjur se sfida më e madhe e Planit është pikërisht integrimi i zonave rurale, pasi dhe baza e të dhënave është shumë e varfër. Bashkia mund të jetë promovuese dhe mbështetëse e zhvillimit bujqësor, pavarësisht juridiksionit të Ministrive. Agropëpunimi i produkteve bujqësore dhe jo vetëm është një prioritet.
- Njëri prej qytetarëve ngriti shqetësimin për zhvillimin e zonës në rrugën “Ligor Rëmbec”, i cili duhet parë me prioritet për shkak të vendndodhjes së kësaj zone shumë afër me qendrën e qytetit dhe gjendjes tepër kritike të ndërtesave në këtë rrugë. Gjithashtu ai kërkoi që kjo zonë të ketë një rritje të shfrytëzimit. Përgjigjja e ekspertëve të studios ishte se kjo kërkesë do të shqyrtohet.
- Së fundmi, janë ngritur pyetjet nëse Plani i Përgjithshëm Vendor do të mund të hartohet brenda periudhës 4 mujore dhe a do të ketë rregullore të re për ndërtimet në zonën ansambël të qytetit, e cila të mos jetë penalizuese për ndërtimet në këtë zonë por të mundësojë zhvillimin duke ruajtur karakteristikat e kësaj zone. Pjesës së parë të pyetjes i është përgjigjur eksperti i studios konsulente duke sqaruar se koha për hartimin e planit është e pamjaftueshme dhe se studioja ka kërkuar shtyrje të këtij afati. Ndërsa pjesës së dytë të pyetjes i është përgjigjur specialistja e AKPT-së, duke sqaruar se referim do të vazhdojë të jetë VKM 408, pasi të tjerat janë shfuqizuar. Aktet nënligjore mund të rishikohen pas funksionimit të regjistrit elektronik të lejeve, nëse do të konstatohen probleme dhe ankesa dhe nga bashkitë e tjera.

Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit  
dhe Zhvillimit të Territorit

**Zhaneta Lubonja**

Drejtoresha  
Drejtoresha e D.P.K.ZH.T.